



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Abduselam Ramadani
Pronar
Radio Urban FM
R075
Prishtinë

VENDIM: LIC/KPM-2013/10
Ref: 1301/198/KPM/ni

VENDIM

lidhur me ndryshimin e lokacionit të transmetuesit të Radio Urban FM-Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Urban FM është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në komunën e Prishtinës. Radio Urban FM është pajisur nga KPM, me licence afatgjate të transmetimit me datën 12 mars 2010.
3. Me datën 2 shkurt 2012, Radio Urban FM ka dorëzuar në zyrën e KPM-së, një kërkesë për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit, nga pika e transmetimit në Butovc në lagjen Bregu i Diellit afër Qendrës Tregtare.
4. Radio Urban FM, ka kërkuar nga KPM që ta miratojë, lokacionin e transmetuesit duke kaluar nga lokacioni në Butovc, në lagjen Bregu i Diellit, për arsye se gjatë kohës së reshjeve të mëdha atmosferike rruga deri në këtë lokacion bëhet e pa kalueshme. Prandaj, në rastet kur ndodhin prishje në transmetues, nuk mund të intervenohet për të evituar këto prishje dhe si pasojë, transmetuesi mbetet i pa përdorshëm, çka e detyron radion që ta ndërpresë transmetimin.
5. Me datën 3 shkurt 2012, Inxhinieret e Departamentit të Menagjimit të Frekuencave (DMF) të KPM-së, kanë bërë matjet teknike lidhur me vlershimin e mundësisë së ndërrimit të lokacionit të transmetimit. Në bazë të matjeve të kryera është konstatuar se Radio Urban FM mund ta ndërrojë lokacionin e transmetimit duke kaluar nga pika e transmetimit në Butovc në lagjen Bregu i Diellit afër Qendrës Tregtare, pasi që ky ndryshim nuk do të ndikojë në ndryshimin e zonës së mbulimit dhe është në pajtueshmëri me Kushtet Teknike të Licencës.

Arsyetimi


6. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediave audio-vizuale.
7. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafët e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së.*
8. Neni 6.1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termat e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë shumë të nevojshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit të frekuencës dhe i Licencuari kishte një mundësi të arsyeshme që të bënte paraqitjen para KPM-së për sa i përket ndryshimeve të propozuara.*
9. Arsyetimin për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për këtë ndryshim.


Vendim

10. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se ndryshimi i lokacionit të transmetuesit të Radio Urban FM, nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit.
11. Komisioni i Pavarur për Media, vendos që lokacioni i transmetuesit të Radio Urban FM të ndryshohet sipas kërkesës, duke kaluar nga lokacioni i transmetuesit në Butovc në lokacionin e ri në lagjen Bregu i Diellit afër Qendrës Tregtare.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni.


Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012
datë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

N.SH. "Cube"
Pronar: Kreshnik Ceka
OSHP "CUBE TV"
Rr/Nazim Gafurri nr.66
Prishtinë

VENDIMI: LIC/KPM-2013/ 07
Ref: 1301/196/KPM/ni

VENDIM

lidhur me licencimin e ofruesit të shërbimeve programore "CUBE TV" – Fushë Kosovë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për distribuimin kabllor të programeve radiotelevizive në Kosovë (CIMC 2007/04), ka hyrë në fuqi më 06.07.2007. Ndërsa, në bazë të Nenit 16 të Rregullores CIMC 2007/04, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Programore, të cilët do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtjesore dhe të cilat programe do të transmetohen vetëm përmes operatorëve kabllorë.
3. Më 7 dhjetor 2012, kandidati për Ofrues të Shërbimeve Programore "CUBE TV", ka paraqitur aplikacionin për Licencë të KPM-së.

Arsyetim

4. Në bazë të nenit 16.4 të Rregullores 2007/04, Ofruesit e Shërbimeve Programore do të rregullohen sikurse subjekte transmetuese.
5. Kandidati për licencë të KPM-së "CUBE TV", në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhëna e nevojshme për Licencë të KPM-së, për të ofruar shërbime programore në pajtueshmëri me Nenin 16 të Rregullores. CIMC 2007/04.
6. Komisioni i Pavarur për Media, vlerëson se kandidati "CUBE TV" ka ofruar informacione të mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Informacionet e ofruara mund të konsiderohen si informacione bindëse lidhur me skemën programore në përgjithësi, duke paraqitur një strukturë të qartë organizative, informacione rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve programore.

7. Neni 22 paragrafi 2, i Ligjit për KPM përcakton: *Licenca e transmetimit mund t'i lëshohet vetëm personit juridik që përmbush kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe kriteret të cilat KPM-ja mund t'i përcaktojë sipas një procedure të drejtë dhe të hapur të konkurrimit.*
8. Gjithashtu, neni 22 paragrafi 3, përcakton: *Licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdojë t'i jepet: 3.1. partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike.*
9. Përmbajtja e skemës programore ashtu siç e cekë edhe kandidati në piken 5.1. do të jetë me karakter fetarë. Prandaj, KPM vlerëson se karakteri i programit të kandidatit për licencë të Ofruesve të shërbimeve Programore është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së përkatësisht neni 22 paragrafi 2, si dhe neni 22 paragrafi 3, pika 1.
10. KPM, vlerëson se ofruesi i shërbimeve programore "CUBE TV" nuk i përmbush kriteret për kualifikim për licencë të KPM-së.

Vendim

11. Komisioni i Pavarur për Media, konkludon se "CUBE TV", ka aplikuar për licencë të KPM-së dhe nuk ka ofruar të gjitha të dhënat e nevojshme për të ofruar shërbime të programeve përmes sistemit kabllor.
12. Komisioni i Pavarur për Media konkludon se karakteri i programit të kandidatit për licencë të Ofruesve të shërbimeve Programore është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së përkatësisht neni 22 paragrafi 2, si dhe neni 22 paragrafi 3, pika 1.
13. Komisioni i Pavarur për Media, vendosë që, ofruesit të shërbimeve programore "CUBE TV", me seli në Fushë Kosovë, t'i refuzoj kërkesën për licencë për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Programore në Republikën e Kosovës, pasi që kërkesa e kandidatit është në kundërshtim me Ligjin e KPM-së.

Lëshimi i Vendimit

14. Këtë vendim e lëshon KPM.

Shefki Ukaj
Kryetar
Komisioni i Pavarur për Media



28.12.2012
datë